

DECENTRALIZATION IN KOSOVO, STATEFUNCTIONING OR FRAGMENTATION OF KOSOVO ON ETHNIC BASIS

Ramë Arifaj

European College Juridica in Kosovo

Abstract: Historically, two major waves of territorial reforms can be observed in European countries. Territorial consolidation reforms in the 1950s and later in the 1960s and 1970s were overwhelmed by the "economies of scale" with desire to provide local services. Most countries that went through this reform (eg, England, the Netherlands and Scandinavian countries) and some of them were from Central and Eastern Europe (eg Poland, Czechoslovakia, Bulgaria and Hungary)³⁶⁹. While in Kosovo this reform began in 1999 at the time when the international community in Kosovo was deployed by United Nations Security Council resolution no# 1244 and thus the administration called UNMIK was established in Kosovo³⁷⁰. In Kosovo after 1999 there are two issues or better to name two processes that have "come" as a consequence of not as a will of people but as the necessity of time under the pressure of the international community, namely decentralization and privatization. In this case or in this study, we will consider the process of decentralization and we will see the advantages and disadvantages of this complex and unusually contested process. Both of these processes are of vital importance for the development and building of society, but the dilemma is that the decentralization process is helping to develop and build the society, or helping to break up the country, is the subject of this paper. The democratic world has chosen these two processes long ago, and while globalization as a global process, given the fact that its main purpose is to increase cross-border contact and as a final product we can say is the loss of borders, in Kosovo this process is often slowing down the processes of democratization of society by conducting experiments and on the other side Serbia's great influence in preventing the expansion of integration processes.

Keywords: decentralization, reforms, democracy, fragmentation

DECENTRALIZIMI NË KOSOVË, SHTETFUNCTIONALIZIM APO COPËTIM I KOSOVËS MBI BAZA ETNIKE

Ramë Arifaj

European College Juridica in Kosovo

Abstrakt: Historikisht, dy valë të mëdha të reformave territoriale mund të vërehen në vendet evropiane. Reformat e konsolidimit territorial në vitet e 50-ta, dhe me vonë në vitet e 60-ta dhe 70-ta, janë inspiruar nga dëshira "economies of scale" në ofrimin e shërbimeve lokale. Shumica e vendeve që kaluan nëpër këtë reformë në atë periudhë ishin vendet e Evropës Perëndimore (sip ah. Anglia, Holanda, dhe vendet skandinave) dhe disa prej tyre ishin nga Evropa Qendrore dhe Lindore (psh. Polonia, Çekosllovakia, Bullgaria dhe Hungaria).³⁷¹ Ndërsa në Kosovë kjo reformë filloj në vitin 1999 në kohën kur Bashkësia ndërkombëtare, në Kosovë vendoset me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nr. 1244 dhe me këtë në Kosovë vendoset administrata e quajtur UNMIK-ut.³⁷² Në Kosovë pas vitit 1999 janë dy çështje apo më mirë të themi dy procese të cilat kanë "ardhur" si pasojë jo e vullnetit të popullit por si domosdoshmëri e kohës nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare, e ato janë decentralizimi dhe privatizimi. Me këtë rast do ta shqyrtojmë procesin e decentralizimit, përparësitë dhe mangësitë e këtij procesi të ndërlikuar dhe jo rrallë të kontestuar. Të dy këto procese kanë rëndësi vitale për zhvillimin dhe ndërtimin e shoqërisë, por dilema se procesi i decentralizimit a është duke ndihmuar zhvillimin dhe ndërtimin e shoqërisë, apo po ndihmonë copëtimin e vendit, është objekt studimi i këtij punimi. Bota demokratike këto dy procese i ka zgjedhur shumë kohë më parë, dhe për derisa globalizimi si proces botëror, duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i tij është rritja e kontaktit përtej kufijve, dhe që si produkt final mund të themi është humbja e kufijve, në Kosovë ky proces po i ngadalëson shpesh here

³⁶⁹Robert D.Ebel dhe Gabor Peteri; Libër udhëzues mbi decentralizimin në Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur (KFOS) dhe Iniciatica për Qeverisje Lokale dhe reformë të Sherbimit Publik(LGI) të Institutit për shoqëri të hapur Budapest, 2007.

³⁷⁰Unmik-u në Kosovë u vendos me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit me 10 qershor 1999

³⁷¹ Robert D.Ebel dhe Gabor Peteri; Libër udhëzues mbi decentralizimin në Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur (KFOS) dhe Iniciatica për Qeverisje Lokale dhe reformë të Sherbimit Publik(LGI) të Institutit për shoqëri të hapur Budapest, 2007,

³⁷². Unmik-u në Kosovë u vendos me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit me 10 qershor 1999

proceset e demokratizimit të shoqërisë, duke bërë eksperimente dhe në anën tjetër ndikimi i madh i Serbisë në pengimin e zgjerimit të proceseve integruese .

Fjalet kyçe: decentralizimi, reformat, demokracioni, copëtimi

HYRJE

Kosova përveq problemeve të shumta ekonomike si pasojë e luftës dhe shkatrrimit që Kosovës i bëri Serbia, ajo tani fillon të ballafaqohet edhe me ligje dhe “reforma” në administratë duke iu imponuar rrethana të reja si pasojë e mosorganizimit të UNMIKU-t. gjatë sundimit të tij. Kosova fillon të përballlet me plane të reja, përveq problemit të “akomodimit” të minoritetit serb i cili i dirigjuar nga Beogradi, ballafaqohet me planin për zbatimin e decentralizimit³⁷³. Me decentralizim nuk mund të zgjidhen të gjitha problemet,³⁷⁴

Pas vitit 1999, me ardhjen e trupave ndërkombëtare, shumica dërrmuese e serbëve të cilët e lëshuan Kosovën, e bënë këtë së bashku me ikjen e ushtrisë dhe policisë së Serbisë.

Në pjesët e brendshme të vendit, serbët u fortifikuan nëpër enklava, në pjesën veriore të saj, ata dëbuan shumicën e shqiptarëve prej atje si dhe instaluan pothuajse gjithë infrastrukturën institucionale të shtetit serb. Në këto hapësira funksionon shteti serb me institucionet e saja ilegale.³⁷⁵ Në anën tjetër në brendi të Vendit serbet janë enklavizuar dhe tentojnë që të formojnë dualizem institucional, ta pranojnë ndikimin e shtetit serb dhe t'i gëzojnë të gjitha të drejtat e Shtetit të Kosovës. Procesi i decentralizimit u kuptua dhe po kuptohet si një proces vetëm për komunitetin serb, dhe për këtë kontributin më të madh është duke e dhënë bashkësia ndërkombëtare dhe me pranimin e palës kosovare.

Fillimi i decentralizimit serbet i gjenë të barrikaduar nëpër enklava, qasja e bashkësisë ndërkombëtare dhe në veçanti Plani i Ahtisarit ofrojë zgjidhje të pjesërishtme, më mirë thënë të gabuar sepse ky proces u trajtua si proces politik, dhe ky është gabim më i madh, problemi i decentralizimit do të duhej të trajtohet si proces i bazuar mbi baza të barazisë dhe bartjes së pushtetit nga qendra poshtë pa dallim, duke mos formuar komuna etnike, sepse kjo ndikon drejtpësdrejt në rritjen e nacionalizmit dhe krijimin e një klime të urrejtjes në mes komuniteteve.

HIPOTEZAT DHE MENDIMET

Në Kosovë Serbet gradualisht fillojnë ta pranojnë realitetin e ri të krijuar, fillojnë pjesëmarrjen në zgjedhje³⁷⁶, në fakt në shiqim të parë fillon krijimi i një klime të volitshme për bashkëjetesë ndërmjet dy komuniteteve kryesore shqiptareve dhe serbeve dhe me këtë fillon apo më mirë të themi vendoset bazamenti i procesit të decentralizimit në Kosovë³⁷⁷, në thelb me këtë proces parashtrihen dy dilema: Decentralizimi a është në “favor” të zhvillimit demokratik dhe ndëretnik apo? Decentralizimi në Kosovë është enklavizim mbi bazën etnike?!

Këto dy dilema janë thelbi i shtjellimit të kësaj problematike, në këtë periudhë bota pra logjikisht edhe Kosova në veçanti, janë pra dy revolucione të politikave që po ngjajnë në tërë botën. sipas KFOS-it i pari është “globalizimi”, i cili përfshin integrimin e tregjeve botërore dhe zvogëlimin e rolit të qeverivë si manipuluese të çështjeve ekonomike. Kjo pritje është veçanërisht dramatike në shtetet ish-komuniste, ku po bëhen aranzhime të reja politike dhe ekonomike për ndërtimin e themeleve të një ekonomie funksionale të tregut.³⁷⁸ Revolucionin tjetër, po aq i rëndësishëm, është decentralizimi, kjo ka të bëjë me pluralizmin, demokracinë, dhe kërkesën e qytetareve për një sistem qeverisës të cilin ata mund ta kuptojnë dhe kontrollojnë.³⁷⁹ Dhe gjatë dekadës së fundit shumica e këtyre veprimeve janë fokusuar në decentralizimin e shteteve të cilat kanë dalur nga ish sistemet, shtete këto të cilat aspirojnë hyrjen në Bashkësië Evropiane.

Kosova, si çdo vend tjetër është një realitet i epokës së globalizimit, kjo në veçanti pas luftës së vitit 1999³⁸⁰ me ardhjen e bashkësisë ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë mundë të themi se është duke u ballafaquar me procese mjaft të ndërlikuara dhe komplekse si zhvillimi ekonomik, reformat në shoqëri, lufta kundër dukurive

³⁷³. Plain i Ahtisarit: 26.mars 2007, Aneksi III i Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari përcakton planin aktual të decentralizimit në Kosovë.

³⁷⁴. Enver, Hoxhaj, interviste dhene Radio Kosova e lire, 06.janar 2005

³⁷⁵. Në veri kemi dualizem institucional, Univerziteti, Komunitat: Zubin Potol, Laposaviq dheleshak dhe Mitrovica Veriore, Policia ilegale serbe, gjykatat, regjistrimi civil etj

³⁷⁶. Pjesëmarrja e sebeve të jugut në zgjedhjet e fundit lokale dhe ato parlamentare.

³⁷⁷. Kipred, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Anaiza Politike 2010/5, 2010, f-6

³⁷⁸. Robert D.Ebel dhe Gabor Peteri; Libër udhëzues mbi decentralizimin në Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur (KFOS) dhe Iniciativa për Qeverisje Lokale dhe reformë të Sherbimit Publik(LGI) të Institutit për shoqëri të hapur, Budapest, 2007, f-13

³⁷⁹ Po aty

³⁸⁰. Rezoluta e OKB, 10 qershor 1999, futja e forcave ndërkombëtare në Kosovë.

negative si dhe proceset integruese, kraha këtyre proceve është duke u ballafaquar me decentralizimin si process demokratik shpesh hërë edhe i kontestuar.

Decentralizimi në Kosovë fillet i ka në vitin 2002, në atë kohë UNMIK-u më në krye me Michal Steinerin, në kuadër të planit 7 pikësh për Mitrovicën, përmendë decentralizimin, pastaj në vitin 2004, saktësishtë pas 17 dhe 18 marsit, Unmik-u decentralizimin e vuri si prioritet, kështu që me 20 korrik 2004 u nënshkrua drafti i parë për decentralizim.

Marrëveshja ofron një sistem të decentralizimit që ka për qëllim të avancojë qeverisjen e mirë, transparencën dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Duke njohur shqetësimet e komunitetit serb në Kosovë, kjo Marrëveshje në veçanti i ofron këtij komuniteti një shkallë të lartë të kontrollit të punëve të tyre. Me marreveshje u vunë themelet e vendimit për themelimin (krijimin) e komunave të reja:

Marrëveshja krijon gjashtë komuna të reja apo komuna me kompetenca shtesë me shumicë serbe të Kosovës: Mitrovica veriore; Graçanicë; Ranillug; Partesh; Kllokot/Vërboc dhe Novobërdë. Komuna e tanishme e Mitrovicës do të ndahet në dy komuna, në Mitrovicë veriore dhe Mitrovicë jugore, me një bashkëpunim dhe bashkërendim mes veti të ndihmuar nga një këshill i përbashkët i ri i formuar. Komunitet shtesë për komunitetet jo shumicë mund të krijohen në konsultim me komunat përkatëse. Dispozitat e Marrëveshjes në lidhje me krijimin e komunave të reja mund të shqyrtohen dhe korrigojnë sipas nevojës nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil pasi të kryhet regjistrimi i popullsisë. Me krijimin e komunave të reja u përcaktuan edhe kompetencat komunale: Të gjitha komunat do të kenë përgjegjësi për fushat që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve kosovar përfshirë: arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm; kujdesin shëndetësor primar publik; zhvillimin ekonomik vendor; planifikimin urban dhe rural; banimin publik; emërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike; dhe ndër të tjera sigurimin e shërbimeve publike dhe komunale.³⁸¹

Përveç kësaj, komunat serbe të përcaktuara të Kosovës do të kenë përgjegjësitë shtesë si në vijim: Komunitet e Mitrovicës veriore, Graçanicës dhe Shtërpçës do të qeverisin me spitale dhe me sigurimin e kujdesit mjekësor sekondar në komunat e tyre. Komuna e Mitrovicës veriore do të ketë përgjegjësitë e caktuara lidhur me universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicë. Të gjitha komunat serbe në Kosovë do të jenë përgjegjëse për mbrojtjen dhe avancimin e çështjeve kulturore dhe religjioze në nivel lokal; Të gjitha komunat serbe në Kosovë do të kenë një rol të avancuar në përzgjedhjen e Komandantëve të stacioneve policore lokale. Çështjet e financave komunale do të zgjidhen si:

Të gjitha komunat do të jenë përgjegjëse për buxhetin e tyre dhe kanë të drejtën për burime financiare vetanake. Do të krijohet një sistem i drejtë dhe transparent i pakos së grandeve, i cili do të siguroj autonomi më të madhe komunale për dhënie dhe shpenzimet e fondeve qendrore. Me decentralizim do të rregullohet Komunitet do të kenë të drejtën e krijimit të shoqatave dhe partneriteteve me komunat tjera në Kosovë për kryerjen e funksioneve me interes të dyanshëm. Komunitet do të kenë të drejtën e bashkëpunimit me komunat dhe institucionet në Serbi, përfshirë edhe të drejtën e pranimit të donacioneve financiare dhe ndihmës teknike nga Serbia, në kuadër të parametrave të qarta përkatëse të cekura në Marrëveshje. Bazuar në faktet e lartpërmendura e ne veçanti lidhja e tyre e drejtëpërdrejtë me komunat serbe dhe duke u bazuar në faktin se si proces në Kosovë nuk është duke u zhvilluar si proces i bartjes së kompetencave nga qendra në bazë pa dallim, por në fakt më shumë është duke u zhvilluar si proces i cili në fakt po krijon komuna të reja etnike, shembujt e deritashem krijimi i komunave: si Graçanica, Parteshi, Kllokoti, Zveçani, etj dhe për këtë arsye po bënë copëtimin e Kosovës mbi bazën etnike, shtrohet pyetja, a thua ky proces është i dobishem apo i dëmshem, apo ndoshta duhet ndryshuar strategjia e metutjeshme e këtij procesi? Kjo dileme dhe ky perceptim do të trajtohen gjatë trajtimit të kësaj teme sa e ndërlikuar po aq edhe e ndieshme.³⁸²

Përcaktimi i temës në aspektin gjeografik është përfshirë në vetë titullin e temës ‘Decentralizimi në Kosovë, shtetfunktionalizim apo copëtim mbi baza etnike’, ndërsa përcaktimi i temës në aspektin kohor e kam analizuar nga koha e pasluftës, pra nga viti 1999 deri sot. Arsyja e përcaktimit për këtë periudhë qëndron në faktin se para vitit 1999 vendi ishte nën okupimin serb, ndërsa pas vitit 1999 ndikim të drejtëpërdrejtë pati në fillim UNMIK-u e tani EULEX-i!

QELLIMI I KËTJË PUNIMI

Gjatë trajtimit të temës ‘Decentralizimi në Kosovë’ që nga fillimi kam tentuar t’i përmbahem koncepteve themelore dhe metodave kërkimore. Duke e bërë një shpjegim kronologjik, pra historik nga fillimi i zbatimit deri më sot, pengesat vështirësitë si dhe mangësitë e mundshme gjatë realizimit të tij.

³⁸¹. *Ligji për Vetëqeverisje Lokale* (Ligji Nr. 03/L-040), http://www.kuvendi.kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf, qasja më 15 May 2009

³⁸² Grupi Ndërkombëtar i Krizave – Raport - Integrimi i Serbëve në Kosovë: *Marrja e Vendimit*. Raporti i Evropës N. 200 – 12 maj, 2009. f.26.

Arsyeja e përcaktimit për këtë temë qëndron edhe në faktin se tema është shumë aktuale dhe që vendi është duke u ballafaquar me këtë dukuri e cila në masë të madhe po ndikon negativisht dhe është duke e dëmtuar vendin, por në temë janë shqyrtuar vetëm arsyet pse është i dëmshëm "Decentralizimi" duke mos u futur në shpjegime se kush, pse është përgjegjës.

Për shkak të kufizimeve vëllimore nuk kam pasur mundësi që t'i argumentoj të gjitha faktet e nevojshme por në masë të mirë janë shpjeguar ecuritë dhe rrjedhat e kësaj dukurie që do ta quaja "eksperiment" që është duke u realizuar në Kosovë.

Në pjesën e parë do të shtjellohet dhe spjegohet kuptimi i decentralizimit, si fenomen i cili në fakt nuk është i dëmshëm, nëse realizohet mbi parimet themelore të decentralizimit e jo si të ne. Me tutje do të trajtohen vështirësitë të cilat po e përcjellin këtë proces, kam bërë disa analiza të decentralizimit në vendet e tjera dhe e kam krahasuar me decentralizimin te ne.

Kapitulli i tretë fletë për "përparësitë" dhe për 'Decentralizimin në Kosovë', mënyrën se si është duke ecur, pengesat dhe vështirësitë që ka ky proces i cili më shumë mund të karakterizohet si proces politik e jo si proces i cili ka për qëllim bartjen e pushtetit nga qendra në bazë, pra zhvillimin e demokracisë.

Në kapitullin e IV kam folur për decentralizimin dhe mangësitë, ndërsa në kapitullin e pestë kam folur për Qeverisjen dhe administratën lokale, reformat e pushtetit lokal, fillimin e këtyre reformave pengesat dhe sfidat me të cilat është duke u ballafaquar me paqartësitë dhe krijimin e komunave të reja etnike.

Qëndrimet që kanë shkencëtarët, politikanët, analistë të ndryshëm dhe qytetarët lidhur me këtë dukuri si dhe në fund, bazuar në të arriturat gjate këtij punimi kam paraqitur disa konkluzione dhe rekomandime. "Është i papranueshëm vizatimi i hartave etnike në Kosovë në emër të procesit të decentralizimit"³⁸³

Qëllimi i këtij punimi është që në pika të shkurtra të shtjelloj decentralizimin në përgjithësi duke u fokusuar në ecurinë e rrjedhës së këtij procesi në Kosovë. Këtij vështrimi iu kam qasur për arsye se, pas futjes së Kosovës nën administrimin civil ndërkombëtar si një fazë kalimtare e zgjidhjes së statusit përfundimtar, decentralizimi është bërë njëra ndër çështjet kyçe si nga arena politike dhe po ashtu dhe nga shoqëria civile Kosovare. Në shumë raste ky proces është trajtuar më shumë si proces politik se sa një proces i natyrshëm dhe i doemosdorsëm për bartjen e disa përgjegjësive nga qendra poshtë dhe afrimin e pushtetit afër qytetarit me qëllim që edhe qytetari të jetë pjesëmarrës aktiv në procesin e vendimarrjes.

Decentralizimi është kuptuar nga udhëheqësit dhe nga qytetarët Kosovar në dy këndvështrime. Këndvështrimi i parë është së decentralizimi është i dobishëm për shoqërinë Kosovare dhe domosdoshmëria e tij mund të dërgoi deri të plotësimi i standardëve që në atë kohë janë kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare si kusht i doemosdorsëm për ndërtimin e shtetit ligjor dhe përgatitjen për integrim në strukturat evropiane dhe evropatlantike, që si proces pushtetit do ta ofrojë më afër qytetarit, ndërsa këndvështrimi i dytë është së decentralizimi, në formën se si është duke u realizuar te ne nuk është i dobishëm për Kosovën për arsye se nuk mund të kemi decentralizim kur nuk kemi centralizim, dhe nga ky këndvështrim decentralizimi mund të çojë deri të "kantonizimi i Kosovës".

Këndvështrimi im prekë të dy anët nga pak, si atë pozitiv, dhe po ashtu atë negativ që ndikojnë në proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Dyshimi se ky proces do të dështojë, në fakt do të ndikojë që të krijojmë komuna mbi baza etnike është i bazuar në faktin se deri sot, të gjitha komunat që janë formuar janë formuar mbi bazën etnike, dhe kjo do të ketë pasoja të mëdhaja negative në proceset e metutjeshme të shtet ndërtimit, do të krijojë enklava, dhe si pasoje mbikqyrja demokratike do të jetë e pamundur, dhe në fund përmes rekomandimit do e nxjerrë një version timin duke u bazuar në gjendjen aktuale nëpër të cilën po kalon decentralizimi, duke e krahasuar më përvojat pozitive dhe negative të këtyre proceseve në vendet me demokraci të avansuar.

Kosova që nga viti 1999 është nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara, të cilat për të qeverisur me territorin e saj kanë instaluar administratën e UNMIK-ut, duke i dhënë fuqi veprimi të plotë në të gjitha fushat në Kosovë.

Pushteti i UNMIK-ut buronte nga rezoluta 1244³⁸⁴ e cila në atë kohë kishte autorizuar atë në ushtrimin e pushtetit në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të saj. Ky pushtet i UNMIK-ut ishte parashikuar të bartet në mënyrë graduale te vendorët pasi që me rastin e nënshkrimit të Kornizës Kushtetuese me 15.05.2001 ajo krijojë bazën juridike për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme dhe për krijimin e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të cilat tashmë ekzistojnë që nga viti 2001 kur dhe u mbajtën zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë. Për të ndodhur bartja graduale e pushtetit prej UNMIK-ut të institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës duhej që këto institucione të tregojnë seriozitet dhe përkushtim në punën e tyre në mënyrë që me rezultatet të cilat do t'i arrijnë të bindin UNMIK-un që të bëjë transferimin e kompetencave në duart e tyre. "Në kushtet e tanishme është me shumë rëndësi që të bëhet të kuptojnë se ato që ata kërkojnë nga shqiptaret në Kosovë, shqiptaret në pjesën jugore të Serbisë mund t'i kërkojnë nga serbët,

³⁸³ Stavileci, Esat; Kites e pergaditur për konferencën "Procesi i Decentralizimit-Mesimet nga Maqedonija" e mbajtur në Prishrinë me 5 prill 2006.

³⁸⁴ Unmik . nuk bëri sa duhet për rregullimin e kësaj çështjeje.

Daniel Server vazhdon dhe thekson se shqiptaret e Kosovës duhet të marrin shumë seriozisht çështjen e trajtimit të pakicave dhe të japin garanci sigurie për to³⁸⁵

Kosova para shpalljes se pavarësisë prioritet kishte përmbyshjen e standardeve si dhe procesin e decentralizimit në Kosovë. Këto prioritet vlejën edhe sot, se a duhet të këtë prioritet kjo çështje apo duhet të zhvillohet krahas zhvillimeve tjera është një pikëpyetje e madhe.³⁸⁶ Kosova sot ka prioritet tjera si zhvillimi ekonomik, shtrirja e sovranitetit në tërë territorin e saj, njohja nga shtetet që ende nuk e kanë njohur, lufta kundër korrupsionit dhe dukurive tjera negative, integrimi në struktura Evropiane dhe Evro-Atlantike etj.

Kur jemi të decentralizimi, çështja e tij ka kohë që ka zërë vend në agjendat e institucioneve të Republikës së Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare por edhe në agjendën e kryeqendrës serbe e cila po i kushton vëmendje të posaçme këtij procesi duke dalë edhe me projekte dhe duke bërë kështu përpjekje të pa ndashme për ta kthyer tërë procesin në favor të pakicës serbe e cila manipulohet apo thënë më mirë vetë shpreh dëshirë për tu manipuluar dhe dirigjuar nga strukturat serbe.

Sot, kemi një situatë ku perveq 5 komunave etnikisht të pastra e që kontrollohen nga Beogradi si (Zubin Potok, Leposaviq, Zveqan, Novoberd, dhe Shterpece, kemi formimin edhe të komunave tjera si: Veriun e Mitrovicës, Graçanicën, Ranillullun, Parteshin dhe Klllokotin), deri me tani këto komuna kanë vështirësi të mëdhaja me funksionimin si komuna të pavarura për shumë arsye, e ndër themeloret janë: buxheti, territori, kapacitetet njëzëzore, si dhe problemet tjera, Këto komuna , finansohen nga Qeveria e Kosovës I ndihmon Beogradi dhe llogari ne shicen e rasteve i japin Beogradit.)

Lidhur me procesin e decentralizimit, UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës kanë krijuar grupin punues për vetëqeverisjen lokale në përbërjen e të cilit janë të përfshirë:nga ekspertet vendor e ndërkombëtar, me qëllim të reformave në qeverisjen lokale, kjo reformë ka për qëllim të kontribuoj në sigurimin e qëndrueshmërisë qeverisjes dhe të kushteve të jetesës për banoret e Kosovës.

Procesi i reformës së qeverisjes lokale kërkon përkushtimin e fortë të të gjitha palëve për një Kosovë shumetnike, ku të gjithë, pavarësisht nga përkatesia etnike, race ose feje, janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, pa armiqësi ose rrezik dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për secilin siç është përcaktuar edhe në dokumentin “Standardet për Kosovën”.³⁸⁷ Reformimi i qeverisjes lokale është një kontribut i rëndësishëm për të ngritur dhe konsoliduar institucionet funksionale demokratike në Kosovë, si një nga standardet për Kosovën. Prandaj, reformimi i qeverisë lokale është kontributi kryesor për të ecur përpara në arritjen e standardeve. Ai kërkon një përkushtim tërësor dhe të mirëfilltë të autoriteteve publike si dhe angazhimin total e të interesuarve në të gjitha nivelet, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile. Ky koncept kornizë shënon fillimin e procesit politik të reformës së qeverisjes lokale në Kosovë, ku e “drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj”.³⁸⁸

Pra ky është propozimi, në pika të shkurtra, i grupit punues për vetëqeverisjen lokale.Në kundërshtim me këtë, plani i qeverisë së Serbisë është shumë më i gjerë, më ambicioz dhe më vëllimorë ashtu siç e thotë edhe vetë titulli i tij “Plani për zgjidhjen politike të situatës së tashme në Kosovë”³⁸⁹ dokument politik ky që insiston në autonominë territoriale të bashkësisë serbe përmes rajoneve autonome të ndëlidhura në mes vete, por brenda palës serbe ka kundërshtime të shumta për decentralizimin në Kosovë.

Politikanët serb janë të ndarë në dy grupe, njeri kërkon decentralizimin dhe tjetri ndërprerjen e decentralizimit në përgjithsi, ata besojnë vetëm në variantin e kthimit të Kosovës nën Serbi apo në ndarjen e saj.³⁹⁰

Plani i qeverisë së Serbisë i cili parashihet autonominë territoriale, kufij etnik dhe bashkim terriroresh, që praktikisht nënkupton transferin e mijëra Shqiptarëve nën administrimin e serbeve lokal, nuk ka gjasa që të pranohet, jo vetëm nga shqiptarët por as nga aktorët kryesor në bashkësinë ndërkombëtare.

Koncepti fillestar i Shqiptarëve është që së pari të bëhet bartja e autorizimeve në organet e pushtetit në Kosovë gjë kjo e cila mundë të shkaktoj konflikt mes pjesëmarrësve tjerë në grupin punues e sidomos kur t’i shtonim edhe planin që së fundi kanë paraqitur ekspertet e KE-së i cili është kundërshtuar nga anëtarët vendorë me arsyetimin se i jep ngjyrimet etnike procesit të decentralizimit dhe kjo do të çonte drejtpërsëdrejti në krijimin e enklavave të reja serbe dhe mundësinë e lidhjes së tyre me enklavat ekzistuese. Përçarjet eventuale në grup do të shkonin në favor të qeverisë serbe e cila rri zgjuar vazhdimisht dhe e gatshme për t’i arritur qëllimet e veta.

³⁸⁵ Serwer,Daniel, Interviste ne RTK, gjate nje vizite ne Prishtine, prill 2006.

³⁸⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave – Raport - Integrimi i Serbëve në Kosovë: *Marrja e Vendimit*. Raporti i Evropës N. 200 – 12 maj, 2009. f.26.

³⁸⁷ Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale (IKQL) Raport. *Korniza dhe Dispozitat për Komunitetet Pakicë*, 5 maj, 2009.

³⁸⁸ Qeverisja lokale dhe organizimi territorial, Neni 123{Parimet e Përgjithshme}, pika 1.

³⁸⁹ Plani i Qeverisë së Serbisë për zgjidhjen e situatës politike ne Kosovë, 29 prill 2004,Neni 1-5,

³⁹⁰ Qerveria e Sebisë në vazhdimësi nxerr rezoluta me të cilat “forcon” bindjen se Kosova është pjesë e pandashme e serbisë.

Për procesin e decentralizimit ka ide dhe mendime të ndryshme, por pavarësisht prej kësaj, sot po të shikojmë gjendjen reale që mbretëron rreth këtij procesi në Kosovë, mund të vërejmë se enklavat serbe funksionojnë politikisht dhe administrativisht pavarur nga Kosova, ato kanë shkollat, ambulancat e spitalet e tyre, ato kanë universitetin në Mitrovicë, ato kanë tani dhe gjyqin e tyre në Graçanicë, ato bëjnë jetë të pavarur në të gjitha pikëpamjet në Kosovë. Kjo lë të kuptohet se plani i qeverisë serbe është mjaft i pranishëm.

Se cili lloj decentralizimi do të zbatohet në Kosovë mbetet të shifet. Por ai mund të jetë decentralizim i cili manifestohet vetëm në formë të delegimit të kompetencave nga qendra te njësitë d.m.th në këtë rast qendra mban për vete vendosjen dhe kontrollin, ky lloj decentralizimi është sinonim me dekoncentrimin.

Tipi i dytë i decentralizimit është ai organizativ i cili përcillet me krijimin e njërive të reja dhe bartjen e të drejtës për vendosje dhe kontroll në disa fusha dhe për disa çështje jo të gjitha. Dhe tipi i tretë i decentralizimit është ai politik i cili në vete përmban bartjen e të drejtës për vetëvendosje dhe kontroll në njësitë më të ulëta. Ky tip decentralizimi tentohet të zbatohet në Kosovë në mënyrë që të krijohet një numër më i madh i njërive të cilat karakterizohen me një autonomi në të cilën përfshihet e drejta e krijimit të njërive gjyqësore, policore të cilat shumë lehtë mund të shëndërrohen në gjykata respektivisht polici, atëherë kjo nënkupton krijimin e “minishteteve” brenda Kosovës.

Këto ndarje dhe lidhje Kosovës do t'i japin formën e të ashtuquajturës lëkurë LEOPARDI,³⁹¹ dhe kështu do të mbanin lidhje me qendrat tjera jashtë Kosovës.

Qysh në fillim të shtjellimit të decentralizimit si proces, do të dëshiroja të përmendë disa nga përparësitë që ofron decentralizimi, sepse nuk mund të kundërshtohet decentralizimi si proces për shkak të shumë përparësive që ka dhe ato i referohen “shpërndarjes së përgjegjësive në më shumë shkallë, afrimin e shërbimeve qytetarit, shkurtimin e rrugës së komunikimit të pushtetit me qytetarin, përshtatjes kushteve dhe rrethanave të mjedisit të caktuar, identifikimit më të lehtë të parregullsive, individualizimit të përgjegjësive”³⁹².

Por, Prof Stavileci nuk ndalet vetëm në përparësitë të cilat i ofron decentralizimi pa i përmend edhe mangësitë të cilat ka ky proces siç janë; “mungesa e kujdesit për interesin më të gjerë, theksimi i tepruar i interesit të pjesshëm dhe mosfunksionimi i kontrollit”³⁹³.

Sa i përket përparësive të cilat i posedon decentralizimi si proces mendoj se në rastin e Kosovës përparësitë e decentralizimit nuk janë të përshtatshme. E them këtë, për arsye se Kosova ende nuk posedon centralizimin e plotë. E mbase nuk ka centralizim si mund të ketë decentralizimin. Duke u bazuar në atë se njëra ndër përparësitë e decentralizimit është bartja e kompetencave nga qendra në organet më të ulëta, ne, duhet të kemi parasysh se Kosova nuk i posedon të gjitha kompetencat në qendër. Andaj mbase nuk i kemi të gjitha kompetencat në qendër, si mund t'i shpërndajmë ato.

Në anën tjetër ky lloji decentralizimi është vetëm në funksion të serbeve punon vetëm për të mirën e një pjese të popullatës, në këtë rastë asaj serbe dhe me këtë ndikon drejtpërsëdrejti në një forme apo tjetër në ndarje të territorit brenda territorit apo më mirë të themi krijon shtet brenda shteti sepse komuna në bazë të ligjit mbi funksionimin e komunave ka përgjegjësi të mëdha deri te emërimi i Komandanteve të stacioneve policore, ka pavarësi ekonomike si dhe privilegje tjera, pra ne shek XXI po krijojmë komuna një-etnike e bota në anën tjetër vazhdon me idenë e integritimit.

Zbatimi i ligjeve dhe politikave të avancuara për pushtetin lokal me qëllim integrimin e qytetarëve në vend sfidohet për faktin se Kosova në nivelin e qeverisjes lokale nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe kadrovike.³⁹⁴ Gjatë kësaj konference, ekspertet vendor dhe ndërkombëtar paraqiten të arriturat dhe sfidat e zbatimit të legjislacionit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

Dr. Balazs Vizi, nga Instituti Hulumtues për Minoritete Etnike dhe Nacionale i Akademisë së Shkencave të Hungarisë tha se ‘Kosova në nivel lokal ka kapacitete të mangëta, mirëpo ka treguar përkushtim të thellë në terren, si dhe ka marrë obligime të mëdha nëpërmes ligjeve në fuqi. Por, në këto rrethana qeverisja lokale nuk mund të jetë shumë efikase pasi që zbatimi i ligjeve varet nga konteksti komunal dhe kapacitetet e administratës për të vepruar. Besnik Tahiri, drejtor i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale theksoi se me Kushtetutë, me ligjet në fuqi, komunave i është atribuar një numër i madh i kompetencave dhe përgjegjësive ekzekutive, dhe mundemi të theksojmë se ky është një zhvillim pozitiv. Megjithatë, duke konsideruar volumnin e

³⁹¹ Lekura Leopardi, nënkupton ndarjen e Kosovës në baza etnike,

³⁹² Prof Esat Stavileci, *Intervistë në radio Evropa e lirë*, Intervistuar nga Rrahman Paqarizi.

³⁹³ Po aty, intervista e njëjtë nga i njëjti gazetar dhe e njëjta radio

Demokraci Tranzicion (ICDT) në Ulqin të Malit të Zi, organizoi konferencën në lidhje me ‘Zbatimin e ligje’³⁹⁴

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në partneritet me Qendrën Ndërkombëtare për ve mbi përdorimin e gjuhëve në komunat e Kosovës’, si dhe ‘Përmirësimi të Politikave Qeverisëse në Nivel Lokal’.

Kjo është konferenca e dytë me radhë e organizuar nga KLGJ dhe ICDT.

Bashkë-organizatorët, së bashku me përfaqësues të komunave dhe ekspertë të pushtetit lokal diskutuan legjislacionin dhe rregulloret e përdorimit të gjuhëve në nivelin e qeverisjes lokale, në veçanti të atyre në Prizren dhe Pejë.

madh të nevojave dhe kërkesave për shërbime, si dhe presionin në rritje nga ana e qytetarëve kundrejt komunave për të sjellë më shumë cilësi dhe efikasitet, atëherë mund të konstatojmë se aktualisht përballemi me një hendek mes kapaciteteve dhe mundësive komunale. Në këtë drejtim, përjashtim nuk paraqesin as zbatimi i legjislacionit për gjuhët, si dhe politikave të qeverisjes së mirë. Prandaj, lirisht mund të thuhet se komunat duhet përkrahur nga faktori ndërkombëtar, qeveria qendrore, si dhe të interesuar të tjerë, në të kundërtën ato nuk mund të konsiderohen si institucionet e vetme përgjegjëse për ngecjet sepse edhe sipas Z. Enver Hoxhaj “Decentralizimi nuk mund të zgjidhë gjithë problemet e serbëve në Kosovë”.³⁹⁵

Decentralizimi, adreson një mori komplikimesh të cilat lidhen ngushtë me aspekte të cilat prekin çështjen e përmirësimit të legjislacionit, të politikave, të praktikave, si dhe shkëmbimit të informacionit në komuna, si dhe në marrëdhëniet e tyre me institucione tjera lokale, qendrore dhe ndërkombëtare.

Decentralizimi si term dhe nocion, në jetën e përditshme, teorinë juridike dhe politike, mund të ketë kuptime të ndryshme, por decentralizimi është nocion ekskluzivisht administrativ që ka të bëjë në ndarjen e funksioneve dhe pushtetit gjithnjë në favor të njëjësive administrative komunale përkatësisht nën-komunale etj. Me decentralizimin kemi të bëjmë me avancimin e mëvetësisë së organeve lokale të pushtetit ndaj organeve qendrore.³⁹⁶

Pra, decentralizimin të cilën e vëmë në këtë kontekst kërkon mbështetje të madhe që duhet të përkojë me vullnetin politik të popullit shumicë në Kosovë, dhe në asnjë mënyrë nuk do duhej të pranohet kurrfarë decentralizimi që bie ndesh me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Rregulloës 2000/45 të UNMIK-ut, Kornizës Kushtetuese të Kosovës dhe decentralizim, sipas shijes së Beogradit që nëpërmjet tij tentojnë të bëjnë një enklavizim dhe “territorializim politik” në Kosovë. Për organet qendrore të pushtetit dhe ato lokale në Kosovë janë dhe duhet të jenë të papranueshme tendencat e krijimit të njëjësive nën-komunale administrative ndarjes territoriale në baza etnike, të krijimit të enklave të pastra nacionale, krijimin e organeve paralele të pushtetit ose veprime tjera që do të rrezikonin rendin unik komunal përkatësisht rendin unik kushtetues të Kosovës. Por pushteti lokal duhet konceptuar, në realizimin e barabartë të drejtave individuale dhe kolektive të qytetarëve dhe të gjitha bashkësive që jetojnë në Kosovë.³⁹⁷ Decentralizimi konsiston në statusin e caktuar apo në drejtimin e lëvizjeve të raporteve politike- juridike ndërmjet organeve qendrore në kuptimin vertikal të pushteteve shtetërore në njërin anë dhe pushtetit lokal në kuptimin horizontal në anën tjetër. Po kështu, decentralizimi reflektohet edhe nga statusi funksional i organeve qendrore dhe lokale, të shprehur në pajtim me juridiksionin dhe kompetencat materiale të tyre. Konkretisht, shkalla dhe cilësia e pavarësisë së organeve të pushtetit shtetëror lokal, ndaj atyre qendrore, në këtë apo atë trajtë, reflekton karakterin dhe natyrën e decentralizimit të pushtetit shtetëror.³⁹⁸

Decentralizimi si kategori juridiko-politike dhe institut juridik, mund të manifestohet në forma dhe përmbajtje më se të shumta dhe të ndryshme, siç mund të jenë autorizimet e organeve qendrore të pushtetit shtetëror për emërimet dhe shkarkimet të funksionarëve lokalë publikë, definimi ligjor i burimeve të financimit të organeve lokale në favor të pavarësisë së financimit të tyre, transferimi apo bartja e autorizimeve të funksioneve të caktuara nga organet qendrore në organet lokale të pushtetit shtetëror, definimi kushtetues, përkatësisht ligjor i shkallës së caktuar të statusit të pavarur të organeve lokale të pushtetit shtetëror etj.

Kuptimi i gjerë i decentralizimit konsiston në çfarëdo dobësimi të influencës funksionale të organeve qendrore të pushtetit shtetëror në të mirë dhe favor funksional të organeve lokale të pushtetit shtetëror.

Dobësimi i influencës së organeve qendrore në të mirë të organeve lokale të pushtetit shtetëror, mund të shkaktohet nga shkaqe dhe motive më se të ndryshme, siç mund të jetë: tendenca për demokratizimin e shoqërisë politike; reformimi shoqëror-politik në përputhje me realitetet politike dhe vullnetin politik të popullit, në tërësi apo segmente relevante të tij; degradimi i strukturave shtetërore dhe forcimi i formacioneve politike apo ushtarake për pavarësim politik të tyre etj.

Vlen për të theksuar se për deri sa Kosova ishte e okupuar nga Serbia, nga organet dhe institucionet përkatëse të Serbisë në dëm të popullatës shqiptare u miratuan ose u nxorën jo më pak se 50 ligje mohuese dhe mbi 500 akte të tjera, ku më këtë është rrënuar tërësisht pushteti shtetëror, rendi kushtetues qendror i Kosovës si dhe rendi valid komunal nëpër komunat e Kosovës.³⁹⁹ Koncepti i pranueshëm për decentralizimin e pushtetit

³⁹⁵. Intervistë e Z. Enver Hoxhaj dhënë Radio Kosova e lirë me 06.janar 2005

³⁹⁶. Prof. Dr. Bajrami, Arsim; “Kushtetuta dhe të Drejtat e Qytetarëve”, Shtëpia Botuese Libri Shkollor Prishtinë, 2001. fq.42

³⁹⁷. Bajrami, Arsim; Vjetari 2000, Botues SHPK Prishtinë 2000, f-46

³⁹⁸. Prof. Dr. Riza SMAKA Kumtesë e organizuar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës Sesion Shkencor: “Decentralizimi në Kosovë-Koncepti, Brengat dhe Rekomandimet nga Kosovarët” Prishtinë, 14.5.2003.

³⁹⁹. Dr. Fejzulla BERISHA “Mohimi i lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë 1990-1996” me një veshtrim historik që nga viti 1912 Teze e disetacionit të doktoratës të mbrojtur në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Tiranë 06.04.1999

qendror do të ishte duke u mbështetur në përvojat e vendeve-shteteve që janë në procesin e raporteve të tranzicionit, nga ish shtetet moniste në shtete pluraliste me demokraci parlamentare, në ato shtete të cilat me aktet e tyre përkatëse kanë konceptuar modelet e qeverisjes lokale bashkëkohore, por pa e anashkalluar përvojat e Kosovës në të kaluarën dhe organizimin e tanishëm të pushtetit lokal në Kosovë.

Prej përparësive të decentralizimit është edhe ajo se, decentralizimi i lejon qytetarëve të merren dhe të vendosin mbi çështjet e lidhura me komunën e tyre dhe kështu të ndikojnë në realizimin e interesave të tyre si dhe të kërkojnë përgjegjësi nga organet të cilat ata i kanë zgjedhur përmes zgjedhjeve lokale.

Procesi i decentralizimit mundëson efikasitetin e qeverisjes në nivel lokal dhe qendror duke e “shkarkuar” pushtetin qendror nga përgjegjësitë dhe detyrat që mund të kryhen në nivel komunal dhe ndihmon në implementimin efikas të vendimeve dhe ligjeve. Bën integrimin e minoriteve në shoqëri duke iu mundësuar atyre që në nivelin lokal të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë institucionale. Decentralizimi nuk do të thotë autonomi për minoritete, por do të thotë autonomi për komuna. Decentralizimi do t’i mundësojë komunave të kenë kompetenca më të mëdha në kuadrin e qeverisjes lokale⁴⁰⁰.

Autonomia e komunave është me rëndësi të veçantë për procesin e demokratizimit. Autonomia iu mundëson komunave kompetenca më të mëdha dhe qytetarëve mbikëqyrje me të madhe ndaj ekzekutivit. Autoritetet lokale nuk janë dege e ekzekutivit qendror por janë institucione që dalin nga zgjedhjet lokale. Për këtë arsye këto autoritete duhen të gëzojnë të drejtat vetëqeverisëse në mënyrë që të realizojnë mandatin e tyre të besuar nga qytetarët në zgjedhjet lokale. Duke e shtjelluar këtë proces nga aspekti i njëanshëm ose i kufizuar është krijuar një përshtypje se ky proces ka për qëllim ndarjen territoriale të Kosovës. Kësaj i kanë kontribuar edhe propozimet e Serbisë për kantonizim dhe më vonë për decentralizim. Kësaj pastaj ju kanë shtuar thashethemet se dokumenti për reformën e qeverisjes lokale të Kosovës përmban edhe kërkesat serbe për kantonizim e kështu me radhë. Kosova në këtë moment kaprioritete tjere me të rëndësishme si: Shtrirja e sovranitetit, zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit etj. Sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti kosovar për hulumtimin dhe zhvillimin e politikave (KIPRED)⁴⁰¹ në lidhje me decentralizimin, rezultojnë se shumica e të intervistuarve për procesin e decentralizimit nëpër të cilin po kalon Kosova shprehën se: Decentralizimi nuk është prioritet i shoqërisë, studimi i ndarjes territoriale i komunave mund të bëhet vetëm mbasi të jetë përcaktuar statusi përfundimtar i Kosovës; dhe decentralizimi i pushtetit nuk mund të ndodhë para centralizimit të tij⁴⁰².

Sipas këtij studimi të bërë me qytetarët kosovarë rezultojnë se shumica e të intervistuarve deklarohen për mangësitë të cilat i bartin procesi i decentralizimit në përdhën nëpër të cilën po kalon Kosova. E megjë qytetarët deklarohen kundër procesit të filluar, në mund të konkludojmë se modelin e decentralizimit do të duhej ta sugjeronin qytetarët, sepse atyre ju referohet. Një çështje tjetër është se më decentralizim mund të shkon edhe deri të ndarja e Kosovës. Shumë politikanë edhe ndërkombëtarë, edhe vendorë thonë se Kosova nuk do të ndahet dhe serbët nuk do të fitojnë ndonjë autonomi brenda Kosovës. Në fakt Kosova është e ndarë dhe veriu i Kosovës, jo vetëm që ka autonomi, por ai është një “shtet” brenda autonomisë së Kosovës në kuadër të Serbisë. Kështu që shqetësimi bazohet në realitetin faktik e kjo është që Kosova realisht është e ndarë. Ky është realiteti, deshëm apo nuk deshëm kur për herë të parë u përpilua projekti për decentralizimin e Kosovës nga Misioni i Këshillit të Evropës, nga shefi i këtij Misioni Carlo Civileti i tha se decentralizimi i pushtetit në Kosovë, nuk do të fillojë pa mënjanimin e të gjitha strukturave paralele⁴⁰³.

Mirëpo kjo nuk po ndodhë sot e sa muaj mbas deklaratave të këtyre zyrtarëve ndërkombëtarë. Me decentralizim jo vetëm që nuk po shihen strukturat paralele, por ato vetëm sa po forcohen tash me bisedimet e Vjenës, duke kërkuar lidhje vertikale me Beogradin.

Sa i përket mangësive të cilat i disponon decentralizimi në rastin e Kosovës, citoj prof Esat Stavilecin, ku shumë mirë sqaron këtë problem ku thotë se “institucionet e Kosovës ende nuk kanë pushtet dhe më pak centralizim, dhe megjë nuk kanë centralizim si do të mund të decentralizohet, pastaj a mund të de-pushtetëzohet Kosova para se të pushtetëzohet, sepse Kosova edhe ashtu nuk është e pushtetëzuar, meqenëse siç e dini, pushtetet tjera janë në duart e përfaqësuesit special. Dilemë tjetër është se Kosova mund të reduktohet në kornizat e qeverisjes vendore dhe të mbetet një vakum më i gjatë, dhe se duhet të kemi parasysh se institucionet tona nuk kanë kompetenca të plota dhe se ato kompetenca që i kanë nuk i shtrijnë autorizimet e tyre në tërë territorin e Kosovës”,

⁴⁰⁰ Korniza për Qeverisjen Lokale në Kosovë, miratuar nga Qeveria, Korrik, 2005

⁴⁰¹ Kipred

⁴⁰² Instituti Kosovar për hulumtimin dhe zhvillimin e politikave (KIPRED), Seria e kërkimeve politike, Studimi #4, “Qeverisja dhe Administrata Lokale në Kosovë” Prishtinë, 2004. Fq.96

⁴⁰³ Me rastin e dorëzimit të projektit të decentralizimit për Kosovën nga Këshilli I Evropës, kryetarit të Parlamentit Nexhat Daci.

Reforma e qeverisjes lokale u shndërrua në çështje të rëndësishme në tetor të vitit 2002, kur Përfaqësuesi i atëherëshëm Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Michael Steiner, premtoi se do t'i decentralizonte strukturat e qeverisjes lokale, me shpresë se kjo do ta inkurajonte bashkësinë serbe që të dilte në zgjedhjet lokale. Përkundër faktit se kjo është një çështje që ka rëndësi qenësore për qytetarin kosovar në përgjithësi, në Kosovë decentralizimi është një temë që në mënyrë integrale është e lidhur me politikën ndërmjet komuniteteve, madje edhe më shumë që nga shpërthimi i dhunës ndëretnike në mars 2004.

Hulumtimi i KIPRED-it tregon se ndarja territoriale e komunave të tashme, në përgjithësi, nuk do ta përmirësojë autonominë lokale të shumicës së bashkësive etnike, sepse ata që tani janë kryesisht të përqendruar në komuna ku janë numërikisht në shumicë, apo janë të shpërndarë ashtu që nuk mund të formojnë një njësi kompakte territoriale.

Andaj, në vend se ta konsiderojmë decentralizimin si rrugëzgjdhje për të gjitha problemet e minoriteteve etnike, duhet përqendruar në zhvillimin e mekanizmave që e forcojnë zërin e komuniteteve brenda sistemit komunal ekzistues. Mekanizmat që ofrojnë siguri shtesë për komunitetet në nivelin lokal duhet të mirëpritën, mirëpo ato duhet të zhvillohen së bashku me masat e tjera të ofruara në nivel qendror. Efikasiteti i qeverive dhe administratave lokale është qenësor në ndikuar nga dinamikat politike në nivelin lokal, që përfshijnë rivalitetet ndërmjet dhe brenda partive, si dhe raportet me organizatat partiake në nivelin qendror. Konfliktet e tilla politike e vështirësojnë funksionimin efektiv dhe efikas të komunave, dhe kanë efekt negativ në besimin afatgjatë të votuesve në proceset dhe partitë politike. .

Qëllimi i kësaj do të ishte të identifikohen mekanizmat që do t'i forconin lidhjet e përgjegjësive ndërmjet partive në qeveri dhe degëve ekzekutive komunale, e në këtë mënyrë të forcoheshin edhe lidhjet e përgjegjësive ndërmjet votuesit dhe partisë në pushtet. Këto probleme politike vetëm sa i theksojnë problemet e mëdha ekzistuese administrative nëpër komuna. Shumica e administratave komunale janë institucione joefikase, me një numër të fryrë të punëtorëve dhe struktura që nuk japin llogari; ato kanë mungesë të personelit cilësor, sidomos nga aspekti teknik.

Përderisa ka përjashtime të dalluara, shumica e administratave komunale ballafaqohen me problemet e etikës së dobët të punës, pasi që nëpunësit civilë rrallëherë frikësohen se do ta humbasin vendin e punës për shkak të cilësisë së dobët të punës.

Shpjegimi kryesor për një gjendje të tillë është se linjat e përgjegjësive, që i lidhin nëpunësit civilë, politikanët dhe votuesit, nuk janë të përkufizuara qartë.

Një mënyrë e shpejtë e zgjidhjes së këtij problemi është që, në nivel Kosovar, të përpilohen standardet e punës për secilin post dhe departament komunal.

Kjo do të ndihmonte që kriteret e tashme politike, të cilat përdoren për zgjedhjen e punëtorëve komunalë, të zëvendësohen me kriteret e bazuara në meritë. Nga aspekti financiar, komunat varen thellësisht nga qeveria qendrore, pasi që një pjesë relativisht e vogël e buxheteve komunale financohet nga të hyrat komunale.

Komunat nuk mund të bëjnë shumë për zhvillimin ekonomik lokal, pasi që më se gjysma e buxheteve të tyre janë të ndara për pagat e nëpunësve civilë, ndërkaq më pak se një e pesta e buxhetit komunal shfrytëzohet për investime kapitale. Kjo varësi financiare është rritur që nga hyrja në fuqi e Rregullores 000/45 – që rregullon qeverisjen lokale në Kosovë – ku burimet e rëndësishme të hollave janë duke u centralizuar në mënyrë progresivisht.

Për ta zvogëluar varësinë financiare të komunave, hapi i parë do të ishte që të aprovohet një ligj i ri për qeverisje lokale,⁴⁰⁴ i cili do t'i ripërkufizonte kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisë dhe i cili do të përmbante mekanizma garantues se të drejtat dhe burimet financiare të komunave nuk do të cenohen më vonë me anë të direktivave arbitrare nga qendra.

Për shkak të mungesës së praktikave standarde dhe uniforme të kontabilitetit, është vështirë të bëhet një krahasim i projekteve të investimit nëpër komuna, që është një mangësi, si për hartuesit e politikave në nivelin qendror, po ashtu edhe për votuesin, i cili i financon këto projekte me anë të tatimeve që paguan. Andaj, ministria përkatëse në qeveri duhet t'i rishikojë praktikatat aktuale të kontabilitetit nëpër komuna, dhe të kërkojë njëtrajtshmëri të raporteve financiare, të cilat duhet t'i afrohen praktikave moderne të kontabilitetit.

Qëllimi i këtij studimi është që ta ofrojë një diagnozë fillestare mbi problemet e qeverisjes dhe administratës lokale në Kosovë, dhe t'i sugjerojë disa opsione për përmirësimin shkurt të vitit 2003, i cili kishte për detyrë përpilimin e një strategjie për reformën e qeverisjes dhe administratës lokale në Kosovë. Misioni i prezantoi rekomandimet finale në nëntor 2003, të cilat përqendroheshin në krijimin e njësieve nën-komunale me autonomi relativisht të lartë politike dhe administrative nga komunat e tashme në Kosovë.

⁴⁰⁴1 *Ligji për Vetëqeverisje Lokale* (Ligji Nr. 03/L-040), <http://www.kuvendi>

kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf, qasja më 15 May 2009 duhet të ndryshohet, sepse i njeiti nuk është në favor të ndërtimit të demokracisë dhe bashkëjetesë.

Që nga ky moment, çështja e decentralizimit u vogëlua paksa në diskursin publik, edhe pse kjo temë vazhdoi t'i frikësojë shqiptarët e Kosovës se ky proces mund ta sfidojë autoritetin e qeverisë qendrore dhe të rezultojë në ndarjen territoriale të Kosovës.

Ndërkohë, me qëllim të përmirësimit të rregullores së UNMIK-ut për vetëqeverisje lokale, por duke mos e adresuar çështjen e decentralizimit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Procesi i decentralizimit në përgjithësi është proces i cili shënon suksesin më të madh në konsolidimin e bashkëjetesës në mes të shqiptarëve dhe serbëve në një Kosovë të pavarur. Decentralizimi po tregohet të jetë mjeti më i suksesshëm për të ruajtur dhe zhvilluar karakterin multi-etnik të vendit. Megjithatë, mundë të konstatojmë se decentralizimi në Kosovë, në mënyrë se si është duke u realizuar më shumë ndikon në barikadimin e serbeve, krijimin e enklavave, krijimin e komunave etnike, të cilat deri më tani nuk po mund të konsolidohen, nuk kanë arritë të formojnë një administratë publike efikase, dhe këto arsye për shumë arsye, mirëpo kryesorja është se kemi krijuar mini shtete në kuader të Shtetit të Kosovës, dhe kjo vetëm sa e vështirëson bashkëjetesën, në fakt kjo qonë edhe më shumë deri të ndarjet etnike dhe territoriale, ekzistojnë në kundërshtim me politikat integruese të BE-së. Me decentralizim pjesëmarrja e serbëve në zgjedhjet e Kosovës ka qenë vetëm një sukses për një pjesë të tyre, por jo për të gjithë sepse ata ende janë të dirigjuar nga Beogradi.

Në mënyrë që të përmirësohen dinamikat aktuale të procesit të decentralizimit, të mënjanohet decentralizimi mbi baza etnike, rekomandojmë:

1. Institucionet e Kosovës në bashkëpunim me Institucionet ndërkombëtare edhe një here ta shqyrtojnë këtë proces dhe ky proces të zhvillohet si proces i ofrimit të pushtetit më afër qytetarit pa dallim, duke përdorur përvojat nga shtetet demokratike.

2. Që procesi i decentralizimit të shkojë në favor të bashkëjetesës, në mes të shqiptarëve dhe serbëve në një Kosovë të pavarur e jo ndarjes në vija etnike.

3. Autoritetet Kosovare duhet të vazhdojnë me përfundimin e decentralizimit, duke përmirësuar pushtetin e vet, të deleguar dhe të zgjeruar të komunave. Komunitetet e reja ballafaqohen me sfida që duhet të adresohen në periudhën afatshkurtër në mënyrë që të mos humbet momenti politik dhe mbështetja e komuniteteve serbe në Kosovë.

4. Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë me përfundimin e legjislativacionit për decentralizim,

3. Komunitetet pa dallim duhet të përshpejtojnë procedurën e bartjes së kompetencave nga qendra të komunave e reja.

4. Qeveritë komunale duhet të hartojnë legjislativacionin sekondar që është i nevojshëm për decentralizimin e mëtejshëm të pushtetit.

5. Duhet bërë presion tek bashkësia ndërkombëtare që ajo të bëjë tryzni mbi Beogradin, në mënyrë që mos të perzihet në punët e brendshme të Shtetit të Pavarur e Sovran.

6. Duhet shuar të gjitha strukturat ilegale të pushtetit serb që veprojnë brenda territorit të republikës së Kosovës.

7. Qeveria e Kosovës duhet të hartojë strategjinë konkrete lidhur me integrimin e veriut të Kosovës, e cila do të kombinonte masat politike, ekonomike dhe ato të ndërtimit të besimit.

8. Efekti i decentralizimit në mënyrë se si është duke u realizuar është shumë i dëmshëm për shoqëri në vehte për qonë mesazhe jo të bashkëjetesës por kundërshtojnë qonë deri të ndarja dhe izolimi. Prandaj si i tillë duhet të ndërpritet deri të konsolidimi i plotë i një strategjie për decentralizim.

9. Duhet parandaluar zgjerimin e enklavave ekzistuese, legalizimin dhe zyrtarizimin e strukturave etnike, pastaj duhet parandaluar ndërlidhjen territoriale të enklavave dhe përfundimisht duhet parandaluar krijimin e etnitetit autonom serb brenda Kosovës.

10. Prandaj njëherë duhet siguruar sovranitetin e plotë mbi territorin e Kosovës pastaj duhet të bisedohet për menyrat dhe format e decentralizimit në Kosovë duke i ofruar shërbimin afër qytetarit pa dallim.

11. Serbet duhet të behen pjesë aktive e proceseve të zhvillimit të Shtetit të ri

të Kosovës, nëse po, vetëm atëherë duhet vazhduar me procesin e decentralizimit të “shëndosh”, pra jo në baza etnike.

12. Duhet të definojmë qartazi cilat janë kriteret për decentralizim, a është territori, a është numri i banorëve apo “përkatesia etnike”, kjo duhet të behet kriter për të gjithë pa dallim,

BIBLIOGRAFIA

[1] Bahl, Roy W. 1999. Implementation Rules for fiscal Decentralization. Atlanta, Georgia USA: Georgia State University, <http://aysps.gsu/publications>.

[2] Bird, Richard M., Robert D. Ebel, dhe Christine I. Wallich. 1995. Decentralization of the Socialist State, Uashington, DC: Banka Botërore.

- [3] Robert D.Ebel dhe Gabor Peteri; Libër udhëzues mbi decentralizimin në Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur (KFOS) dhe Iniciativa për Qeverisje Lokale dhe reformë të Sherbimit Publik(LGI) të Institutit për shoqëri të hapur, Budapest, 2007,
- [4] Kipred, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Anaiza Politike 2010/5, 2010,
- [5] Projekti i decentralizimit për Kosovën nga Këshilli i Evropës (KIPRED), Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave, Analiza Politike 2010/5 “Qeverisja dhe Administrata Lokale në Kosovë” Prishtinë, 2004.Epoka e Re, 04 janar 2005,
- [6] Korniza për Qeverisjen Lokale në Kosovë, miratuar nga Qeveria, Korrik, 20057. Ligji për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), http://www.kuvendikosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf, qasja më 15 Maj 2009.
- [7] Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian – 2008, nëntor 2008
- [8] Akademik Esat Stavileci,, “Intervistë në radio Evropa e lire”, Intërvistuar nga Rrahman Paqarizi,